

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike si më poshtë:

A. 2 (dy) vende pune për personel akademik të kategorisë “Asistent Lektor” në Departamentin e Inxhinierisë Matematike.

Kriteret e pranimit për staf akademik akademik kategoria Asistent Lektor në Departamentin e Inxhinierisë Matematike:

1. Të kenë diplomë universitare: cikli i dytë “Master i Shkencave” sistemi (3+2) ose diplomë e integruar (sistemi 5-vjeçar) në degët: Inxhinieri Matematike të fituar pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Universiteti Politeknik i Tiranës, në degët Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatike të fituar pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, ose Matematikë Speciale të fituar pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.
2. Të kenë diplomë universitare ekuivalente me diplomat e pikës 1, të fituara në universitete jashtë vendit. Diplomat duhet të jenë të njohura e ekuivalentuara nga MAS.
3. Të kenë notë mesatare të ponderuar, në secilin nga ciklet e studimit (Bachelor dhe Master i Shkencave) mbi 8.5.
4. Preferohen kandidatët me përvojë në mësimdhënie dhe aktivitet akademik.
5. Të kenë dy rekomandime nga punëdhënësit të mëparshëm apo personalitete akademike.
6. Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe pune në grup.
7. Ndaj tij të mos jenë marrë masa disiplinore.
8. Të mos jetë i dënuar.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;

7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **12.09.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.